

## **DEKLARATË POLITIKE E SUBJEKTIT POLITIK-KANDIDAT I PAVARUR PËR KRYETAR KOMUNE**

### **DUKE U NISUR NGA:**

- Fakti se shumica dermuese e qytetarëve të Komunës së Malisheves, janë të brengosur dhe shprehimisht e në vazhdimësi të pakënaqur me gjendjen dhe me qeverisjen e gjërtanishme në qytetin e Malishevës dhe në Komunë përgjithsisht,

Se në qytet dhe gjithandej në Komunën e Malishevës, ka shumë problem të mprefta e serioze, që kërkojnë udhëheqës dhe udhëheqje dukshëm më serioze , më profesionale.

Se qytetarët janë të prirur deri në gadishmëri maksimale , që të përfaqësojnë parimet gjithëpërfshirëse demokratike.

### **KAM VENDOSUR QË,**

**NË KETO ZGJEDHJE TË GAROJ- NË CILËSI TË KANDIDATIT TË PAVARUR- PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË MALISHEVES.**

**NDAJ NË FUNKSION TË ARRITJES DHE PËRMBUSHJES SË SYNIMEVE, VIZIONIT DHE OBJEKTIVAVE TË MIJA POLITIKE.**

### **DEKLAROJ SE:**

- Gjatë angazhimit tim eventual politik dhe faktik, do të punoj shumë në afirmimin dhe avansimin maksimal të vlerave dhe meritave të qytetarëve dhe institucioneve përkatëse kompetente shtetnore –parësisht në nivel lokal, respektivisht komunal,
- Për mundësi dhe gjasa të barabarta të qytetarëve në punë dhe jetë, si dhe për konkurrencë lojale e të lirë – në treg të lirë, për iniciativë të lirë, ekonomi të tregut dhe biznes etik,
- Do të angazhohemi dhe përkushtohemi në luftimin e pakompromis të korrupsionit, mitos dhe krimin të organizuar,
- Do të zotohemi që nga fillimi e në vazhdimsi në luftimin e të gjitha dukurive negative në shoqëri.

- Do të punoj shumë për zhvillimin edhe më të hovshëm të demokracisë, respektimin e të drejtave dhe lirive themeloretë njeriut – pa asnjë dallim – në çfardo baze.
- Më ekipin tim do të punojmë dhe angazhohemi maksimalisht për afrimin e vlerave dhe të barazisë gjinore , kundër dhunës së çfardollojshme dhe kundër diskriminimit.
- Do të jetë orientim kryesorë i gjithë asamblesë, për të vendosur , që qdo familje e varfër , të tetë së paku një të punësuar në cilindo sektor .
- Do të zotohemi për respektimin e plotë të të drejtave dhe dhënien me kohë të prestacioneve të luftetarëve t ëish UÇK-së, të veteranëve dhe të gjitha kategorive të ivaliditetit.
- Për interesin e përgjithshëm dhe të përbashkët, do të bashkëpunojmë pa asnjë paragjykim dhe kusht, me secilin subject politik,për të mirën, te komunës sonë dhe Republikës së Kosovës në përgjithësi.

**Malishevë 17.07.2017**

**SELAJDIN BYTYQI**

